

A K T T H E M E L I M I

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“DION-2022” Shpk

Date 13 / 12 / 2022

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE

Z. Zenel Dulla, i biri i Fadilit, lindur ne Kavaje, me 26.12.1992, banues ne Qerret Kavaje, shtetas shqiptar, identifikuar me leternjofimin me numer 033208027, me date leshimi 08.09.2016, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Mbeshtetur ne Ligjin nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" dhe Ligjin Nr.9723 date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit" dhe ne Legjislacionin shqiptar ne pergjithesi, personi i mesiperm, eshte Ortak i Shoqerise.

Emertimi, Selia dhe afati i Shoqerise

Neni 1

Shoqeria eshte person juridik Shqiptar, veprimtaria e se ciles rregullohet nga ky Akt Themelimi, Statuti i saj dhe Legjislacioni ne fuqi.

Neni 2

Shoqeria eshte emertuar “DION-2022” shpk.

Neni 3

Shoqeria ka Seline e saj ne: Rruga Henz, Zona Kadastrale nr.3101, Pasuria nr.14/299, Pasuria nr.14/300-Qerret –Kavaje.

Neni 4

Shoqeria do te zhvilloj aktivitetin e saj me afat te pakufizuar. Ky afat mund te shkurtohet me vendim te Ortakut te Vetem.

Shoqeria “DION-2022” shpk gezon statusin e personit juridik shqiptar nga momenti regjistrimit si e tille ne Qendren Kombetare te Biznesit.

Neni 5

Shoqeria “DION-2022” shpk zhvillon aktivitetin e saj si me poshte :

Hoteleri - Turizem, Bar -Restorant, Fast-food. Dhenia me qera e banesave dhe vendosja e zhezlloneve ne bregdet. Agjensi udhetimi dhe akomodimi ne fushen e turizmit. Tregti me pakice dhe shumice i artikujve ushqimore, import - eksport I artikujve ushqimore, artikujve te akeizes, birre me ambalazhe te ndryshme, produkteve te konsumit te gjere, ushtrimi I cdo veprimtarie te ligjshme, te lejueshme per formen e shoqerise.



Neni 6

Shoqeria ushtron aktivitetin e saj ne Shqiperi dhe jashte saj.

Neni 7

Selia e shoqerise mund te transferohet.

Neni 8

Kapitali i shoqerise "DION-2022" shpk eshte 418.000.000 leke

Ky kapital vjen nga ndarja e kapitalit te shoqerise "Brillant Hotel & SPA" shpk , e cila sipas kotave te regjistruara ne Qendren Kombetare te Biznesit ka nje kapital prej 836.000.000 lekesh i ndare ne dy kuota dhe dy ortake vellezer te cilet per arsye familiar dhe me mirekuptim te plote desherojne te ndahen dhe ku Ortaku Elton Dulla do te marr 1 (nje) kuote me vlere 418.180.000 leke dhe qendron ortak i vetem ne shoqerine "Brillant Hotel & SPA" shpk, ndersa Oratku Zenel Dulla do te marr 1 (nje) kuote me vlere 418.180.000 leke dhe largohet nga shoqeria "Brillant Hotel & SPA" shpk ne shoqerine ne krijim e siper "DION-2022" shpk si ortak i vetem.

Pjese e ketij Akt Themelimi eshte dhe vendimi i Asamblese Ortakeve te shoqerise "Brillant Hotel & SPA" shpk te dates 12.12.2022 per ndarjen e kapitalit si me siper.

Kapitali i shoqerise "DION-2022" shpk si me poshte:

Zenel Dulla = 1 Kuote = 100% = 418.000,000 Lek

Neni 9

Shoqeria mund te hyje ne veprimtari te perbashketa me shoqeri te tjera shqiptare ose te huaja edhe kur ato nuk kane objekt aktiviteti ate te shoqerise.

Neni 10

Veprimtaria e shoqerise mund te ushtrohet duke krijuar filiale ose perfaqesi brenda dhe jashte vendit, ne konformitet me ligjin shqiptar ose te huaj.

Administrimi

Organi vendimor i shoqerise eshte Ortaku i Vetem.

Neni 11

ADMINISTRATORI / ADMINISTRATORET

Ne shoqerine "DION-2022" shpk administrator i shoqerise do te jete Z. Zenel Dulla Administratori emerohet per nje afat kohor prej 5 vjetesh. Administratori ka te gjitha kompetencat per te kryer te gjitha veprimet me interes te shoqerise dhe ne emer te saj nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e veprimtarise se shoqerise me perjashtim te atyre kompetencave qe ligji nuk i njeh. Administratori ndryshohet me vendim te Ortakut te Vetem.

Mbyllja e Shoqerise:

Neni 12

Veprimtaria e shoqerise pushon me propozimin e bere nga Ortaku i Vetem, kur gjate dy vjeteve nuk rezulton rentabel si dhe ne te gjitha rastet qe parashikohen ne dokumentet e



krijimit te shoqerise. Shoqeria shperndahet ne forme riorganizimi ose likujdimi.

Kur shoqeria likujdohet:

Neni 13


Ortaku i Vetem emeron likujdatorin dhe shoqeria i jep fund veprimtarise se saj ne castin e miratimit te ketij bilanci te likujdimit. Komisioni i Likujdimit perbehet nga nje ose tre antare. Pasurite qe jane vene ne dispozicion te shoqerise me te drejte shfrytezimi, shiten ne vartesi te shkalles se konsumit te tyre. Mjetet financiare te fituara si rezultat i veprimtarise se shoqerise e te fililave te saj dhe fondet financiare i kalojne Ortakut, pasi te jene bere pagesat per kreditoret.

Neni 14

Kur pushon veprimtaria e nje filiali, per efekte te riorganizimit te tij, afatet e pushimit caktohen nga Ortaku i Vetem. Likujdimi i filialeve behet njelloj si per shoqerine. Mjetet financiare te fituara si rezultat i veprimtarise se filialit te likujduar dhe fondet e tij financiare vihen ne dispozicion te shoqerise pasi tu jene bere pagesat likujdatoreve. Dispozita te hollesishme mbi organizimin e kesaj shoqerie percaktohen ne statutin e saj.

**ORTAKU I VETEM
"DION-2022" shpk**

Zenel Dulla



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE DURRËS
NOTER ALBANA H. HOTI



DATE 13/12/2022
NR REP 2927

VËRTEPIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 13 Dhjetor 2022 , para meje Notere ALBANA H. HOTI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore DURRËS, me zyrë në adresën Durres, NR.4, EGNATIA, NR.405, u paraqit personalisht:

NËNSHKRUES:

Zenel Dulla, atësia Fadil, amësia Hasbije, shtetas Shqiptar, lindur në Kavajë dhe banues në KAVAJË, me adresë Hencve 04060064; Nd. 132; H. 1; Golem; Qeret; 2504; Kavajë, lindur më 26/12/1992, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033208027 dhe nr. personal J21226044C , i cili u paraqit personalisht para meje Noteres dhe nenshkroi aktin e perpiluar jashte kesaj Zyre Noteriale si meposhte: .

Subjektet e mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noteres, “Aktin e Themelimit” "DION-2022", bashkëlidhur.

Unë Noterja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma “ë”, si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 “Për Noterinë”, dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave Personale”, unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTERE

ALBANA H. HOTI

